



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.22

6 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 075
datë 12.2.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar” 1385

Ligj nr.10 078
datë 16.2.2009

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar 1392

Udhëzim i MF
nr.23, datë 5.3.2009

Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit 1397

LIGJ
Nr.10 075, datë 12.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6076, datë 27.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (këtu quhen palë),

duke rënë dakord për të zhvilluar bisedime mbi çështje politike dhe të sigurisë dhe për të zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimin e tyre reciprok;

duke qenë të ndërgjegjshme për ndryshimet në situatën politike në botë dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për stabilizimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit reciprok;

të bindura që bashkëpunimi i mirë mund të kërkojë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve;

me synim garantimin e mbrojtjes reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar, që është klasifikuar nga një palë dhe transferuar palës tjetër,

me dëshirën për të vendosur rregulla mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar që do të shtrihen te të gjitha marrëveshjet mbi bashkëpunimin që përfundohen ndërmjet palëve dhe te kontratat që u jepen organizatave të palëve, që parashikojnë shkëmbimin e informacionit klasifikuar,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” do të thotë:

- Për Republikën e Shqipërisë:

“Sekret shtetëror”, në bazë të ligjit, do të thotë informacion i klasifikuar, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të dëmtojë sigurinë kombëtare. “Siguri kombëtare” do të thotë mbrojtje e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë.

- Për Republikën e Kroacisë:

Informacion i çfarëdo forme, natyre ose metode transmetimi, i prodhuar ose në procesin e prodhimit, i klasifikuar nga autoriteti kompetent, brenda procedurës së parashikuar dhe për të cilin është përcaktuar niveli i klasifikimit të sigurisë, dhe informacioni që është klasifikuar dhe dhënë i tillë Republikës së Kroacisë nga një vend tjetër, organizatë ndërkombëtare ose institucion me të cilin bashkëpunon Republika e Kroacisë.

2. “Material i klasifikuar” është çdo send makinerie ose armësh apo pajisje, ose mjet i prodhuar ose në procesin e prodhimit, që ruan, përpunon ose transmeton informacion të klasifikuar.

3. “Dokument i klasifikuar” është çdo informacion i regjistruar, pavarësisht nga forma ose karakteristikat e tij fizike, duke përfshirë, pa kufizim, material të shkruar me dorë ose të printuar, kartat e përpunimit të të dhënave dhe shiritat, hartat, tabelat, fotografitë, pikturat, vizatimet, gdhendjet, skicat, shënimet dhe letrat e punës, kopjet e karbonit dhe shiritat me ngjyra ose riprodhimet me çdo mjet ose proces dhe regjistrimet e tingujve, zërit, manjetike ose elektronike, apo optike ose video në çdo formë dhe pajisjet portative për përpunimin automatik të të dhënave me pajisje të palëvizshme të regjistrimit në kompjuter dhe mjetet portative të regjistrimit në kompjuter.

4. “Niveli i klasifikimit të sigurisë” është kategoria, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, që karakterizon rëndësinë e informacionit të klasifikuar, nivelin e kufizimit të aksesit në të dhe nivelin e mbrojtjes së tij nga palët dhe gjithashtu kategoria në bazë të të cilit është shënuar informacioni.

5. “Shënimi i klasifikimit” është një shënim mbi një informacion të klasifikuar, që tregon nivelin e klasifikimit të sigurisë.

6. “Pala pritëse” është pala, e përfaqësuar nga autoriteti kompetent për sigurinë, së cilës i transferohet informacioni ose materiali i klasifikuar.

7. “Pala e origjinës” është pala, e përfaqësuar nga autoriteti kompetent për sigurinë, ku ka origjinën ose që transmeton informacionin ose materialin e klasifikuar.

8. “Palë e tretë” është një organizatë ndërkombëtare ose një shtet i tretë që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

9. “Autoriteti kompetent për sigurinë” është autoriteti kryesor që, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, është përgjegjës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10. Parimi i “nevojës për njohje” është domosdoshmëria për të pasur akses në informacionin e klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare ose përmbushjen e një detyre konkrete zyrtare.

11. “Kontraktorët” është një individ ose një subjekt juridik që ka zotësinë ligjore për të lidhur kontrata.

12. “Kontratë e klasifikuar” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë kontraktorëve që krijojnë dhe përkufizon të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre, që përmban ose përfshin informacion të kualifikuar.

13. “Vizitorë” janë përfaqësuesit zyrtarë të një pale që kërkon të vizitojë objektet dhe ambientet e palës tjetër të përfshirë në aktivitete në lidhje me informacionin ose materialin e klasifikuar.

14. “Certifikata sigurie personeli” është dokumenti i dhënë nga autoriteti kompetent për sigurinë një shtetasi të një pale për akses në informacionin e klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme.

15. “Certifikatë sigurie industriale” është dokumenti i dhënë nga autoriteti kompetent për sigurinë,

që vërteton që një shoqëri/subjekt është i autorizuar për akses në informacionin e klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme.

16. “Deklasifikimi i informacionit të klasifikuar” është heqja e nivelit të klasifikimit të sigurisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

17. “Aksesi i paautorizuar në informacionin e klasifikuar” është çdo formë e deklarimit të informacionit të klasifikuar, abuzimit, dëmtimit, paraqitjes, asgjësimit ose veprimit që rezulton në shkeljen e mbrojtjes ose humbjes së këtij informacioni, si dhe çdo veprim ose mosveprim tjetër që ka rezultuar në bërjen e informacionit të ditur një personi të paautorizuar.

18. “Shkelje e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe rregullohet e brendshme, që rezulton ose mund të rezultojë në akses të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

Neni 2

Nivelet e klasifikimit të sigurisë

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të klasifikimit të sigurisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë, të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret e brendshme të palës përkatëse.

Republika e Shqipërisë
TEPËR SEKRET
SEKRET
KONFIDENCIAL
I KUFIZUAR

Ekuivalenca në anglisht
TOP SECRET
SECRET
CONFIDENTIAL
RESTICTED

Republika e Kroacisë
VRLO TAJNO
TAJNO
POVJERLJIVO
OGRANIČENO

Neni 3

Autoritetet kompetente për sigurinë

1. Autoritetet kompetente për sigurinë të palëve janë si më poshtë:

- Për Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (autoriteti kombëtar për sigurinë).

- Për Republikën e Kroacisë:

- Zyra e Këshillit Kombëtar për Sigurinë (autoriteti kombëtar për sigurinë);

2. Autoritetet kompetente për sigurinë informojnë njëra-tjetrën për ligjet dhe rregulloret e brendshme në fuqi që rregullojnë informacionin e klasifikuar.

3. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunimi i ngushtë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente për sigurinë mund të zhvillojnë bisedime me kërkesë të bërë nga një prej tyre.

4. Me qëllim që të arrihen dhe të mbahen standarde të krahasueshme për sigurinë, autoritetet kompetente për sigurinë, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me standardet e sigurisë, procedurat dhe praktikat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga pala përkatëse.

Neni 4

Masat e brendshme dhe aksesit në informacionin e klasifikuar

1. Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, palët zbatojnë të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, që përgjithësisht gjenerohet ose shkëmbehet sipas kësaj Marrëveshjeje. Për këtë informacion të klasifikuar garantohet i njëjti nivel mbrojtjeje që parashikohet për informacionin e klasifikuar të brendshëm, me nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë.

2. Palët informojnë njëra-tjetrën me shkrim, në kohën e duhur, në lidhje me çdo ndryshim në ligjet

dhe rregulloret e brendshme që prekin mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Në këto raste palët informojnë njëra-tjetrën në pajtim me nenin 3, paragrafi 3 dhe 4, të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të ndikojnë ndryshimet e mundshme të kësaj Marrëveshjeje. Ndërkohë, informacioni i klasifikuar mbrohet në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, përveç kur bihet dakord ndryshe me shkrim.

3. Aksesimi në informacione të klasifikuara kufizohet tek ata persona që kanë nevojë për të ditur, pasi të jenë autorizuar nga autoriteti kompetent për sigurinë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, që përputhet me nivelin e kërkuar të klasifikimit të sigurisë të informacionit që duhet të aksesohet.

4. Pala pritëse:

a) i paraqet informacionin të klasifikuar një palë të tretë vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës;

b) i jep informacionin të klasifikuar nivelin e klasifikimit të sigurisë të barasvlershëm me atë të parashikuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe për pasojë siguron mbrojtjen e barasvlershme me atë të dhënë nga pala e origjinës;

c) përdor informacionin e klasifikuar vetëm për qëllimet që ai është parashikuar;

d) respekton të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të fshehtat tregtare që përfshihen në informacionin e klasifikuar.

5. Nëse një marrëveshjeje tjetër e përfunduar ndërmjet palëve përmban rregulla në rigoze në lidhje me shkëmbimin ose mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, zbatohen këto rregulla.

Neni 5

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar transmetohet nëpërmjet kanaleve diplomatike ose shërbimeve të korrierit ushtarak ose tjetër të miratuar nga autoriteti kompetent për sigurinë. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Nëse duhet të transmetohet një dërgesë e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet përkatëse kompetente të sigurisë bien dakord reciprokisht dhe aprovojnë me shkrim mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për çdo rast të tillë.

3. Masa të tjera të aprovuara të transmetimit ose shkëmbimit të informacionit të klasifikuar mund të përdoren nëse për këtë bihet dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë.

4. Shërbimet e sigurisë dhe informative të palëve mund të shkëmbejnë drejtpërdrejt informacion operativ analitik në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

Neni 6

Shënimi i informacionit të klasifikuar

1. Pala pritëse shënon informacionin e klasifikuar të marrë me shënimin përkatës të klasifikimit në pajtim me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesat e shënimit zbatohen edhe për informacionin e klasifikuar të gjeneruar në lidhje me një kontratë të klasifikuar.

Neni 7

Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i shënuar me një nivel klasifikimi sigurie TEPËR SEKRET/TOP SECRET/VRLO TAJNO lejohet për t'u përkthyer dhe kopjuar vetëm me leje me shkrim të palës së

originës.

2. Të gjitha kopjet e riprodhuara të informacionit të klasifikuar shënohen me një shënim origjinal klasifikimi. Ky informacion i riprodhuar vendoset në të njëjtin kontroll, si dhe informacioni origjinal. Numri i kopjeve është i kufizuar në atë që kërkohet për qëllime zyrtare.

3. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar bëhen nga individë të autorizuar. Përkthimi shënohet me shënimin origjinal të klasifikimit dhe përmban një tekst të përshtatshëm në gjuhën në të cilën ai përkthehet që përkthimi përmban informacion të klasifikuar të palës së origjinës.

Neni 8

Asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikimit asgjësohet në masën që të parandalohet rindërtimi i plotë ose i pjesshëm.

2. Informacioni i klasifikuar i nivelit të klasifikimit të sigurisë TEPËR SEKRET/TOP SECRET/VRLO TAJNO nuk asgjësohet. Ai i kthehet palës së origjinës.

3. Pala e origjinës, me anë të shënimit shtesë ose dërgimit të mëvonshëm të shënimit me shkrim, mund të ndalojë shprehimisht riprodhimin, ndryshimin ose asgjësimin e informacionit të klasifikuar. Nëse asgjësimi i informacionit të klasifikuar ndalohet, ai i kthehet palës së origjinës.

4. Në rastin e një situatë krize, informacioni i klasifikuar, që është i pamundur të mbrohet ose kthehet te pala e origjinës, mbrohet ose kthehet te pala e origjinës, asgjësohet menjëherë. Pala pritëse njofton palën e origjinës me shkrim në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 9

Vizitat

1. Ekspertët e sigurisë të autoriteteve kompetente për sigurinë mund të zhvillojnë konsultime të rregullta për të diskutuar procedurat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

2. Autoriteti kompetent për sigurinë i palës pritëse lëshon autorizim paraprak për vizita për vizitorët që kanë autorizimin e përshtatshëm të sigurisë së personelit, në rast se ata duhet të aksesojnë informacionin e klasifikuar ose ambientet ku ka origjinën, trajtohet ose ruhet informacioni i klasifikuar.

3. Për procedurat e vizitave bihet dakord ndërmjet autoriteteve kompetente për sigurinë të palëve.

4. Kërkesa për vizitë përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datë dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës ose një numër dokumenti tjetër identifikimi;

b) shtetësinë e vizitorit;

c) titullin e postit të vizitorit dhe emrin e organizatës së përfaqësuar;

d) autorizimin e sigurisë së personelit të vizitorit, të nivelit të përshtatshëm të klasifikimit;

e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;

f) emrat e organizatave dhe ambienteve që kërkohet të vizitohen;

g) të dhëna të tjera nëse bihet dakord nga autoritetet kompetente për sigurinë.

5. Autoritetet kompetente për sigurinë e palëve aprovajnë listën e vizitorëve që mund të përsëritin vizita brenda dymbëdhjetë muajve për qëllimin e përmbushjes së kontratës së klasifikuar. Afatet e vizitave të veçanta rregullohen drejtpërdrejt nga autoritetet e përshtatshme të kontraktorëve.

6. Secila palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të brendshme.

Neni 10

Kontratat e klasifikuara

1. Kontratat e klasifikuara përfundohen dhe zbatohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të secilës palë. Me kërkesë të autoritetit kompetent për sigurinë të secilës palë jep një

konfirmim që një kontraktori të propozuar i është dhënë një autorizim i përshtatshëm kombëtar sigurie subjekti, që përputhet me nivelin e klasifikimit të kërkuar të sigurisë. Nëse kontraktori i propozuar nuk ka autorizimin e përshtatshëm sigurie subjekti, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës palë mund të kërkojë që ky kontraktor të autorizohet.

2. Një aneks sigurie është gjithmonë pjesë përbërëse e secilës kontratë ose nënkontratë të klasifikuar, nëpërmjet së cilës kontraktori i palës së origjinës përcakton se cili informacion i klasifikuar duhet të jepet ose gjenerohet nga pala pritëse dhe se cili nivel përkatës i klasifikimit të sigurisë i është dhënë këtij informacioni.

3. Detyrimet e kontraktorit për të mbrojtur informacionin e klasifikuar në lidhje me kontratën e klasifikuar i referohet të paktën sa më poshtë:

a) deklarimit të informacionit të klasifikuar, përjashtimisht personave të cilëve u është dhënë më parë autorizimi i përshtatshëm i sigurisë së personelit, që kanë nevojë për të ditur dhe që janë përfshirë në përmbushjen e kontratës së klasifikuar;

b) transmetimit të informacionit të klasifikuar me mjetet e parashikuara në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

c) procedurave dhe mekanizmave për komunikimin e ndryshimeve që mund të dalin në lidhje me informacionin e klasifikuar;

d) detyrimit për të njoftuar në kohën e duhur autoritetin kompetent të sigurisë së kontraktorit për çdo akses të kryer, në tentativë ose të dyshuar, në informacionin e klasifikuar të kontratës;

e) përdorimit të informacionit të klasifikuar sipas kontratës së klasifikuar vetëm për qëllimet që lidhen me objektin e kontratës;

f) respektimit rigoroz të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me procedurën për trajtimin e informacionit të klasifikuar;

g) dhënies së informacionit në bazë të një kontrate të klasifikuar çdo pale të tretë vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

4. Masat e kërkuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedura për vlerësimin dhe zhdëmtimin për humbjet e mundshme të shkarkuara kontraktorëve nga aksesit i paautorizuar në informacionin e klasifikuar, përcaktohet më me hollësi në kontratën përkatëse të klasifikuar.

5. Kontrata e klasifikuar e nivelit të klasifikimit të sigurisë I KUFIZUAR /RESTRICTED/ OGRANIČENO përmban një dispozitë të përshtatshme për sigurinë që përcakton masat minimale për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Për këto kontrata nuk kërkohet autorizim sigurie subjekti.

Neni 11

Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e një shkeljeje të sigurisë, autoriteti kompetent i sigurisë në shtetin e të cilit ka ndodhur shkelja e sigurisë njofton autoritetin kompetent të sigurisë të palës tjetër në kohën e duhur dhe siguron hetimin e përshtatshëm. Pala tjetër, nëse kërkohet, bashkëpunon në hetim.

2. Në rastin e ndodhjes së shkeljes së sigurisë tek një palë e tretë, autoriteti kompetent i sigurisë i palës së origjinës merr masat sipas paragrafit 1 të këtij neni, sipas rastit.

3. Pala tjetër njoftohet në lidhje me rezultatet e hetimit dhe merr deklaratimet përfundimtare në lidhje me shkaqet e ngjarjes dhe masën e dëmit.

Neni 12

Shpenzimet

Secila palë mbulon shpenzimet e veta të shkarkuara gjatë zbatimit të Marrëveshjes.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje mund të zgjidhet me konsultime dhe negociata ndërmjet palëve pa iu drejtuar juridiksionit të jashtëm.

Neni 14

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet së cilës palët kanë informuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që kërkesat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok me shkrim të palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje përfundohet për një afat të përcaktuar kohe. Secila palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke i bërë palës tjetër një njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj nga data në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.

4. Në rastin e shfuqizimit të kësaj Marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i transmetuar në pajtim me këtë Marrëveshje vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat që gjenden në të.

5. Aspekte të tjera teknike të bashkëpunimit mund të rregullohen me pëlqimin reciprok të palëve.

Bërë në Tiranë, më 19 dhjetor 2008, në dy kopje origjinale, secila në shqip, anglisht dhe kroatisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

LIGJ

Nr.10 078, datë 16.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në të gjithë ligjin, fjala “ditë” zëvendësohet me fjalët “ditë pune”.

Neni 2

Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “dh” shfuqizohet.
2. Në pikën 2, në paragrafin e fundit, fjalët “60 ditë” zëvendësohen me fjalët “10 ditë nga zbardhja”.

Neni 3

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 shfuqizohet.
2. Në pikën 9, fjalët “30 ditë” zëvendësohen me fjalët “5 ditë”.

Neni 4

Në nenin 22/1 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Siguron, me kërkesën e të interesuarit, përditësimet e infrastrukturës rrugore, kanalizime, elektrike, telefonike, intensitetin sizmik mbi bazën e studimit sizmologjik të marrë nga Instituti i Sizmologjisë (pikat 1, 2, 3 dhe 4 të formularit nr.3/1), si shërbim “në një ndalesë” dhe ia dërgon kërkuesit brenda 10 ditëve nga kërkesa.”.

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Përgatit vendimet e KRRT-së dhe dokumentacionin e nevojshëm teknik, bashkë me kushtet urbanistike, sipas studimeve të miratuara.

a) Pas miratimit nga KRRT-ja, kërkuesi është i detyruar të depozitojë, brenda një afati kohor prej 60 ditësh, projektin e zbatimit për objektin.

b) Njësia e urbanistikës, brenda 5 ditëve nga depozitimi i projektit të zbatimit, shqyrton dokumentacionin e depozituar nga kërkuesi, vetëm për çështje të përmbushjes së formës, si dhe i dërgon njoftimin se do të fillojë shqyrtimi i konformitetit të projektit arkitektonik të zbatimit, me rregullat urbanistike dhe vendimin e KRRT-së.

c) Kur njësia e urbanistikës në njësinë vendore, brenda afatit 5-ditor, nuk dërgon në adresë të kërkuesit njoftimin se do të fillojë shqyrtimi i konformitetit të projektit arkitektonik të zbatimit, dokumentacioni konsiderohet i pranuar në heshtje dhe njësia e urbanistikës detyrohet të fillojë shqyrtimin e konformitetit, sipas shkronjës “ç” të kësaj pike.

ç) Njësia e urbanistikës, brenda 10 ditëve, njofton kërkuesin se projekti arkitektonik i zbatimit të objektit është në përputhje ose jo me normat urbanistike dhe vendimin e KRRT-së, si dhe detyrimin për pagesën e taksës.

d) Njësia e urbanistikës shqyrton konformitetin vetëm të projektit arkitektonik të zbatimit të objektit me normat urbanistike dhe vendimin e KRRT-së. Ndërsa për sa i përket projektit konstruktiv dhe atij të instalimeve, projektuesit e veprës, nën përgjegjësinë e tyre profesionale, vetëdeklarojnë, në një deklaratë të posaçme që i bashkëlidhet projektit të depozituar, se kanë hartuar projektin konform të gjitha normave teknike në fuqi.

dh) Në rast se njësia e urbanistikës konstaton se dokumentacioni i kërkuesit, për sa i përket projektit arkitektonik, ka të meta në përmbajtje, i dërgon njoftimin për plotësimin e tyre, duke i vendosur një afat, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Me dërgimin e njoftimit të mësipërm, pezullohet llogaritja e afatit të zbardhjes së vendimit të KRRT-së, deri në plotësimin e të metave nga kërkuesi. Me plotësimin e tyre, kërkuesi rivendoset në afatin 10-ditor.

e) Nëse njësia e urbanistikës, brenda afatit 10-ditor, nuk njofton kërkuesin për të meta në dokumentacionin ose detyrimin e pagesës së taksës, në përfundim të këtij afati dokumentacioni konsiderohet i pranuar në heshtje dhe njësia e urbanistikës është e detyruar të llogarisë detyrimin për pagesën e taksës, sipas nenit 51 të këtij ligji.”.

Neni 5

Në fillim të nenit 38 shtohen paragrafët si më poshtë:

“Kërkuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për miratim:

- a) vetëm të sheshit të ndërtimit dhe të kushteve urbane të tij dhe pas miratimit të lejes së sheshit nga KRRT-ja, në një procedim të ri të kërkojë miratim të lejes së ndërtimit;
- b) të sheshit dhe të lejes së ndërtimit në një procedim të vetëm administrativ;

Kur kërkuesi paraqet kërkesën, sipas shkronjës “a” të paragrafit të parë të këtij neni, afatet dhe procedura e përcaktuar në këtë ligj aplikohen më vete për shqyrtimin e kërkesës dhe miratimin e sheshit të ndërtimit dhe më vete për shqyrtimin e kërkesës dhe miratimin e lejes së ndërtimit.

Kur kërkuesi paraqet kërkesën, sipas shkronjës “b” të paragrafit të parë të këtij neni, kërkesa bëhet sipas formularëve nr.1, 3 dhe 3/1, pjesë e këtij ligji. Kërkesa shqyrtohet në një procedim të vetëm administrativ, sipas afatit të përcaktuar në nenin 45 të këtij ligji.”.

Neni 6

Në fund të nenit 45 shtohen paragrafët si më poshtë:

“- Shqyrtimi i kërkesës kalon në dy faza:

procedimi për shqyrtimin administrativ të kërkesës;

b) shqyrtimi dhe miratimi i lejes së ndërtimit nga organi kompetent, KRRT-ja vendore.

- Procedimi për shqyrtimin administrativ të kërkesës bëhet nga njësia e urbanistikës dhe këshilli teknik në njësinë vendore.

- Njësia e urbanistikës, brenda 5 ditëve, shqyrton dokumentacionin vetëm për çështje të përmbushjes së formës dhe dërgon në adresë të kërkuesit vërtetimin, ku përcaktohet data e marrjes në dorëzim të kërkesës, të dhënat që identifikojnë kërkesën dhe dokumentet bashkëlidhur, si dhe njoftimin se do të nisë procedura e shqyrtimit administrativ të kërkesës.

Në rast se gjatë shqyrtimit për çështje të formës vihen re mangësi në dokumentacionin e kërkuar, sipas këtij ligji, aplikimi nuk pranohet dhe kërkesa së bashku me dokumentet shoqëruese i kthehen mbrapsht kërkuesit me njoftimin se shqyrtimi administrativ i kërkesës nuk ka filluar.

Kur njësia e urbanistikës në njësinë vendore nuk dërgon në adresë të kërkuesit, brenda 5 ditëve, njoftimin se do të nisë procedurën e shqyrtimit administrativ të kërkesës, aplikimi konsiderohet i pranuar në heshtje dhe njësia e urbanistikës detyrohet të nisë procedurën e shqyrtimit administrativ të kërkesës.

– Me fillimin e procedimit për shqyrtimin administrativ të kërkesës, njësia e urbanistikës dhe këshilli teknik duhet të shqyrtojnë kërkesën brenda 35 ditëve nga data, në të cilën kërkesa konsiderohet e pranuar, sipas këtij neni.

Në rast se gjatë procedimit për shqyrtimin administrativ të kërkesës, njësia e urbanistikës konstaton se dokumentacioni i kërkuesit ka të meta tekniko-ligjore në përmbajtje, i dërgon kërkuesit njoftimin për plotësimin e të metave, duke i vendosur një afat, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Me dërgimin e njoftimit të mësipërm, pezullohet llogaritja e afateve të shqyrtimit, sipas këtij ligji, deri në plotësimin e të metave nga kërkuesi. Me plotësimin e tyre, kërkuesi rivendoset në afatin 35-ditor të procedimit për shqyrtimin administrativ të kërkesës.

Nëse edhe pas përfundimit të afatit të vendosur për plotësimin e të metave në njoftim kërkuesi nuk ka plotësuar të metat e konstatuara, atëherë njësia e urbanistikës ndërpret procedimin për shqyrtimin administrativ të kërkesës dhe njofton kërkuesin, duke i kthyer edhe dokumentacionin.

Njësia e urbanistikës dhe këshilli teknik, brenda afatit 35-ditor, duhet të shqyrtojnë kërkesën dhe t'i njoftojnë kërkuesit përfundimin e procedimit të shqyrtimit administrativ të kërkesës, pranimin ose jo të saj.

- Kur njësia e urbanistikës, në përfundim të afatit 35-ditor, nuk dërgon në adresë të kërkuesit njoftimin për:

- a) mospranimin e shqyrtimit administrativ të kërkesës;

b) depozitim për shqyrtimin dhe miratimin e lejes së ndërtimit në KRRT në përfundim të procedimit për shqyrtim administrativ të kërkesës;
atëherë kërkesa konsiderohet e pranuar në heshtje dhe dokumentacioni i përcillet për shqyrtim dhe miratim KRRT-së së njësisë vendore.”.

Neni 7

Në nenin 50, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
“Projekti i paraqitur ka ndryshuar destinacionin e sheshit të ndërtimit, përcaktuar nga studimi urbanistik.”.

Neni 8

Pas nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

“Kalimi për miratim i lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, në shkelje të kushteve urbanistike për dhënien e lejes së ndërtimit, të parashikuara në këtë ligj, përbën mospërbushje të rregullt të detyrës.

Shkelje me dashje e dispozitave për kalimin për miratim të lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, passjell përgjegjësi penale, sipas ligjit.”.

Neni 9

Në nenin 51, në paragrafin e parafundit, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Dokumenti i lejes së ndërtimit i jepet personit fizik apo juridik jo më vonë se 1 ditë pas datës së depozitimit të dokumentit të pagesës në dosjen e objektit. Në rast se kërkuesi nuk kryen pagesën brenda 30 ditëve nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamatë 0,2 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 60 ditë. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet 1 për qind në ditë deri në 30 ditë të tjera. Në rast të kundërt, KRRT-ja vendos masa të tjera të përshtatshme, deri në anulimin e vetë lejes së miratuar.”.

Neni 10

Dispozita kalimtare

1. Ngarkohen institucionet kompetente, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, energjisë elektrike, telekomunikacionit, Instituti Sizmologjik dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të depozitojnë pranë njësive vendore përkatëse të gjitha të dhënat e përditësuara dhe materialin e përditësuar hartografik mbi rrjetet infrastrukturore, si dhe të bëjnë përditësimin periodik 6-mujor të të dhënave mbi rrjetet infrastrukturore dhe t’ia vënë atë në dispozicion njësive vendore përkatëse. Për kalimin e informacionit të mësipërm nuk aplikohet tarifë.

2. Pika 1 e nenit 4 të këtij ligji hyn në fuqi pasi institucionet dhe shoqëritë e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni kanë bërë kalimin e të dhënave hartografike, sipas afatit 3-mujor.

3. Dispozitat e parashikuara në këtë ligj nuk zbatohen për kërkesat e paraqitura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilat janë depozituar ose janë në fazë shqyrtimi nga njësitë vendore.

Neni 11

Formulari 3/1, pjesë e ligjit, ndryshohet sipas formularit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6080, datë 4.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

FORMULAR Nr. 3/1

LIDHJA E OBJEKTIT
ME INFRASTRUKTURËN INXHINIERIKE

OBJEKTI _____

1. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me linjën e ujësjellësit publik:

Pika dhe distanca e lidhjes _____

Shënim i ndërmarrjes së ujësjellësit që administron ujësjellësin publik _____

—

2. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrjetin publik të kanalizimeve të ujërave të zeza:

Pika dhe distanca e lidhjes _____

Shënim i ndërmarrjes së kanalizimeve të ujërave të zeza që administron rrjetin publik _____

—

3. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrjetin elektrik publik:

Pika dhe distanca e lidhjes _____

Shënim i ndërmarrjes elektrike që administron rrjetin elektrik publik _____

—

4. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrjetin telefonik publik:

Pika dhe distanca e lidhjes _____

Shënim i ndërmarrjes së telekomit që administron rrjetin telefonik publik _____

—

5. Verifikimi i sheshit të ndërtimit nga:
Inspektorati sanitar shtetëror i rrethit _____
Agjencia rajonale e mbrojtjes së mjedisit, shoqëruar me lejen e mjedisit për ato raste kur është e
parashikuar në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” _____
Ndërmarrja e mbrojtjes kundër zjarrit _____

Bashkëlidhur formularit, gen-plani i objektit që do të ndërtohet për çdo rast dhe studimi përkatës,
si dhe miratimi i lejes së ndërtimit për punimet e infrastrukturës për çdo rast.

KËRKUESI

(.....)

Datë// 200...

UDHËZIM
Nr.23, datë 5.3.2009

PËR FORMATIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI
LOJËRAT E FATIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit
64 pika 4 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”,
Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Miratimin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit, sipas
formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ky formular do të shtypet në dy (2) kopje, shtypja do të bëhet me letër vetëkopjuese.
Dimensioni i formatit është: A4, me udhëzues traktor. Formulari do të prodhohet në faqe të
formatit “Letër” si formularët e tjerë “traktor”. Shënimet sqaruese për plotësimin e këtij formulari
do të jenë vetëm në pjesën e prapme të kopjes së dytë.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE TATIMIT MBI LOJRAT E FATIT**



(2) Periudha tatimore

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):	(3) _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:	(4) _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5) _____
Adresa qendrore:	(6) _____
Qyteti/Komuna/Rrethi:	_____
(Ploteso Tabela 1)	_____
Numri Telefonit:	(7) _____

☐ Pa veprimtari

(9/10) Bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës, brenda sallës , rreth kat I
(11/12) Bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës, brenda sallës , rreth kat II
(13/14) Bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës, brenda sallës , rreth kat III
Bastet sportive, kuota fikse per pika
(15/16) Bastet sportive, pika ne rreth kat.I
(17/18) Bastet sportive, pika ne rreth kat.II
(19/20) Bastet sportive, pika ne rreth kat.III
Kazino Elektronike, kuota fikse per salle
(21/22) Kazino Elektronike, salla ne rreth kat I
(23/24) Kazino Elektronike, salla ne rreth kat II
(25/26) Kazino elektronike, salla ne rreth kat III
(27/28) Makinë elektronike të tipit slot rreth kat I,II,III
(29/30) Videollotari ,rreth kat I,II,III
(31/32) Makine elektronike (rulete) me më shume se nje pozicion, kuota fikse
(33/34) Makine elektronike (rulete) me me shume se nje pozicion, kuota per pozicion
(35/36) Tryeze me me shume se nje pozicion(rulete), kuote fikse per cdo pozicion
(37/38) Kazino, kuote fikse, per tryezë të lojërave (me letra ose/dhe me zare)
(39/40) Kazino per lojrat elektronike dhe makina slot,me fitim ne cast dhe per videollotari

(41) Bastet per gara ne piste, kuote fikse per shoqerine
(42/43) Bastet per gara ne piste, kuote fikse per cdo pikë të shitjes së basteve
(44/45) Bastet per gara ne piste, per lojrat elektronike, kuote fikse per cdo kompjuter
(46/47) Bastet per gara ne piste, per lojrat elektronike, kuote fikse per pozicion makine

Nr. Sallave/Pozicioneve		Detyrimi
9)	10)	(x500000)
11)	12)	(x400000)
13)	14)	(x300000)
15)	16)	(x 60000)
17)	18)	(x40000)
19)	20)	(x30000)
21)	22)	(x400000)
23)	24)	(x200000)
25)	26)	(x100000)
27)	28)	(x20000)
29)	30)	(x20000)
31)	32)	(x1000000)
33)	34)	(x80000)
35)	36)	(x80000)
37)	38)	(x600000)
39)	40)	(x60000)
	41)	(2000000)
42)	43)	(x40000)
44)	45)	(x40000)
46)	47)	(x40000)

(48/49) Bingo televizive, që nuk zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallave
(50/51) Bastet sportive kuota fikse apo 10% e qarkullimit(Tabela 2)
(52/53) Llotari kombetare, 10% e qarkullimit (Tabela 3)

Qarkullimi	Detyrimi
48)	49)(x 10%)
50)	51)
52)	53)(x 10%)

(54) Tatimi per tu paguar
(55) Denime / interesa per vonesa
(56) TOTALI PER TU PAGUAR

54)
55)
56)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperme eshte i plote dhe i sakte.

PAGESA

Vetem per perdorim zyrtar

Leke

SHUMA E PAGUAR

--

Xhirim

Data , Vula e Bankes dhe nenskrimi i nepunesit te bankes

Originali - Zyra e Tatimeve

Cek

Kopja -Personi i Tatueshem

Te tjera:.....

Tabela 1			
Adresa	specifiko me shenjen X Rreth Kat I	specifiko me shenjen X Rreth Kat II	specifiko me shenjen X Rreth kat III
1. Qyteti/Komuna:			
Nr i telefonit:			
2. Qyteti/Komuna:			
Nr i telefonit:			
3. Qyteti/Komuna:			
Nr i telefonit:			
4.			

Tabela 2			
Adresa	Qarkullimi ne sallat e Rreth Kat I	Qarkullimi ne sallat Rreth Kat II	Qarkullimi ne sallat Rreth Kat III
1. Qyteti/Komuna:			
Nr i telefonit:			
2. Qyteti/Komuna:			
Nr i telefonit:			
3. Qyteti/Komuna:			
Nr i telefonit:			
4.			
Qarkullimi Total sipas rretheve			
Qarkullimi Gjithsej (shumat e qarkullimit te sallave sipas rreth te kat)			

Vendoseni Shumen ne Kutine [50] te Deklarates

Shenim: Nese shuma (10% x qarkullimi gjithsej) del me e vogel se shume 2 000 000 lek, atehere do te paguani si detyrim shumen prej 2 000 000 lek dhe kete shume vendoseni ne kutine [52] te Deklarates

Tabela 3	
Llojet e Lojrave	Qarkullimi (ne lek)
Të gjitha lojërat numerike	
1	
2	
3	
Keno	
Tradicionale	
Elektronike	
Llotari për të cilat hidhet short	
Llotari e çastit	
Qarkullimi Total	

Vendoseni Shumen ne Kutine [52] te Deklarates

Udhëzues për mënyrën e plotësimit të formularit

1. Numri serial gjenerohet nga Dega e Tatimeve dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet kur paraqitet deklarata
2. Periudha Tatimore është mujore, ose pjesë e muajit në rast mbyllje të aktivitetit.
3. Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) është numri i dhënë nga Dega e Tatimeve apo Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve
4. Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it
5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar
6. Adresa tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është treguar edhe në certifikatën e NIPT-it. Në Tabelën 1 duhet të shënohet adresa e sallës/sallave ku ushtrohet aktiviteti i lojrave të fatit, sipas rrethëve të kategorisë
7. Numri i Telefonit (nqs ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike
8. Për veprimtari zgjidhet vetëm nëse nuk është kryer aktivitet gjatë periudhës për të cilën bëhet deklarimi. Vendosi një kryq në kutinë 8, firmoseni deklaratën dhe paraqiteni në bankë.
- 9/10. Numri i sallave në rreth të kategorisë I x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë I
- 11/12. Numri i sallave në rreth të kategorisë II x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë II
- 13/14. Numri i sallave në rreth të kategorisë III x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë III
- 15/16. Numri i pikave në rreth të kategorisë I x kuota fikse për pikë në rreth të kategorisë I
- 17/18. Numri i pikave në rreth të kategorisë II x kuota fikse për pikë në rreth të kategorisë II
- 19/20. Numri i pikave në rreth të kategorisë III x kuota fikse për pikë në rreth të kategorisë III
- 21/22. Numri i sallave në rreth të kategorisë I x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë I
- 23/24. Numri i sallave në rreth të kategorisë II x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë II
- 25/26. Numri i sallave në rreth të kategorisë III x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë III
- 27/28. Numri i makinave elektronike të tipit slot në rreth të kategorisë I, II, III x kuota fikse për makinë
- 29/30. Numri i videolotarive në rreth të kategorisë I, II, III x kuota fikse për videolotari
- 31/32. Numri i makinave elektronike (ruletë) me më shumë se një pozicion x kuota fikse mujore
- 33/34. Numri i makinave elektronike (ruletë) me më shumë se një pozicion x kuota për pozicion
- 35/36. Numri i tryezave me më shumë se një pozicion (ruletë) x kuota fikse për pozicion
- 37/38. Numri i tryezave të lojrave (me letra ose/dhe me zëra) x kuota fikse për tryezë
- 39/40. Numri i tryezave të lojrave (me letra ose/dhe me zëra) x kuota fikse për cdo kompjuter
41. Kuote fikse për shoqëri
- 42/43. Numri i pikave të shitjes së basteve x kuota fikse sipas ligjit
- 44/45. Numri i pikave të shitjes së basteve x kuota fikse për cdo kompjuter
- 46/47. Numri i pikave të shitjes së basteve x kuota fikse për pozicion makine
- 48/49. Qarkullimi x 10%
- 50/51. Kuota fikse sipas ligjit për cdo shoqëri apo 10% e qarkullimit, por jo më pak se 2000000 lek. Tabela 2
- 52/53. Qarkullimi x 10%. Tabela 3
54. Tatimi për tu paguar është shuma e kutive të kolonës detyrimi.
(për 54 = 10+12+14+16+18+20+22+24+26+28+30+32+34+36+38+40+41+43+45+47+49+51+53)
55. Denime/interesa për vonesa janë denimet dhe interesat për vonesat në deklaram ose pagesë që mund të llogariten paraprakisht dhe që mund të paguhën me deklaratën
56. Totali për tu paguar është shuma e tatimit për tu paguar (kutia 56) me denimet dhe interesat e llogaritura me deklaratën (kutia 55). (56=54+55)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.3.2009
Doli nga shtypi më 6.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 20 lekë